



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 256, datë 30.12.2019

PËR

**NJOHJEN DHE REGJISTRIMIN ME KUSHT TË SHOQËRISË “NEWCOM” SH.A. SI
AGJENT I SHOQËRISË SË BROKERIMIT NË TITUJ “F1 MARKETS LIMITED”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 42, pika 10, të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt” dhe Rregullores nr. 71, datë 27.03.2019 “Për veprimtarinë e agjentit të shoqërisë së brokerimit në tituj, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Njohjen dhe regjistrimin me kusht të shoqërisë “NEWCOM” sh.a. për të vepruar vetëm si agjent i shoqërisë së brokerimit në tituj “F1 Markets Limited”, e licencuar nga Komisioni i Letrave me Vlerë të Qipros (SySEC).
2. Aktiviteti i shoqërisë do të fillojë pasi shoqëria të depozitojë në Autoritet dokumentacionin sipas kërkesave të specifikuara në letrën shoqëruese të këtij vendimi.
3. Shoqëria “NEWCOM” sh.a. të depozitojë në Autoritetit dokumentacionin sipas pikës 2 të këtij vendimi, brenda një afati kohor prej 1 (një) muaji nga data e miratimit me kusht të njohjes së veprimtarisë.
4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ervin METE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI